

URDHËR
Nr. 232/1, datë 5.10.2023

**PËR MIRATIMIN E PËRKTHIMIT NË GJUHËN SHQIPE TË NDRYSHIMEVE
NË STANDARDIN NDËRKOMBËTAR TË RAPORTIMIT FINANCIAR “ADOPTIMI
PËR HERË TË PARË I STANDARDEVE NDËRKOMBËTARE TË RAPORTIMIT
FINANCIAR (SNRF 1)”**

Në mbështetje të nenit 3, pika 4 dhe pika 5, të ligjit nr. 10.5.2018, “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 505, datë 17.7.2019, “Për miratimin e rregullores së brendshme të organizimit dhe funksionimit të Këshillit Kombëtar të Kontabilitetit”,

URDHËROJ:

1. Shpalljen e ndryshimeve në Standardin Ndërkombëtar të Raportimit Financiar “Adoptimi për herë të parë i Standardeve Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF 1)”.
2. Ndryshimet e SNRF 1 “Adoptimi për herë të parë i Standardeve Ndërkombëtare të Raportimit Financiar”, të publikuara në gusht 2023, njësia ekonomike i zbaton në të njëjtën kur zbaton ndryshimet e SNK 21.
3. Ky urdhër hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I FINANCAVE DHE EKONOMISË
Ervin Mete

Amendments to IAS 21 *The Effects of Changes in Foreign Exchange Rates*

Paragraphs 8 and 26 are amended. Paragraphs 8A–8B, 19A and their related headings, paragraphs 57A–57B, 60L–60M and Appendix A are added. New text is underlined and deleted text is struck through. For ease of reading, text in Appendix A has not been underlined.

Definitions

8 The following terms are used in this Standard with the meanings specified:

...

A currency is *exchangeable* into another currency when an entity is able to obtain the other currency within a time frame that allows for a normal administrative delay and through a market or exchange mechanism in which an exchange transaction would create enforceable rights and obligations.

...

Elaboration on the definitions

Exchangeable (paragraphs A2–A10)

8A An entity assesses whether a currency is exchangeable into another currency:

(a) at a measurement date; and

(b) for a specified purpose.

8B If an entity is able to obtain no more than an insignificant amount of the other currency at the measurement date for the specified purpose, the currency is not exchangeable into the other currency.

...

Estimating the spot exchange rate when a currency is not exchangeable (paragraphs A11–A17)

19A An entity shall estimate the spot exchange rate at a measurement date when a currency is not exchangeable into another currency (as described in paragraphs 8, 8A–8B and A2–A10) at that date. An entity's objective in estimating the spot exchange rate is to reflect the rate at which an orderly exchange transaction would take place at the measurement date between market participants under prevailing economic conditions.

Reporting foreign currency transactions in the functional currency

...

Reporting at the ends of subsequent reporting periods

...

- 26 When several exchange rates are available, the rate used is that at which the future cash flows represented by the transaction or balance could have been settled if those cash flows had occurred at the measurement date. ~~If exchangeability between two currencies is temporarily lacking, the rate used is the first subsequent rate at which exchanges could be made.~~

...

Disclosure

...

- 57A When an entity estimates a spot exchange rate because a currency is not exchangeable into another currency (see paragraph 19A), the entity shall disclose information that enables users of its financial statements to understand how the currency not being exchangeable into the other currency affects, or is expected to affect, the entity's financial performance, financial position and cash flows. To achieve this objective, an entity shall disclose information about:

- (a) the nature and financial effects of the currency not being exchangeable into the other currency;
- (b) the spot exchange rate(s) used;
- (c) the estimation process; and
- (d) the risks to which the entity is exposed because of the currency not being exchangeable into the other currency.

- 57B Paragraphs A18–A20 specify how an entity applies paragraph 57A.

Effective date and transition

...

- 60L *Lack of Exchangeability*, issued in August 2023, amended paragraphs 8 and 26, and added paragraphs 8A–8B, 19A, 57A–57B and Appendix A. An entity shall apply those amendments for annual reporting periods beginning on or after 1 January 2025. Earlier application is permitted. If an entity applies the amendments for an earlier period, it shall disclose that fact. The date of initial application is the beginning of the annual reporting period in which an entity first applies those amendments.

- 60M In applying *Lack of Exchangeability*, an entity shall not restate comparative information. Instead:

- (a) when the entity reports foreign currency transactions in its functional currency, and, at the date of initial application, concludes that its functional currency is not exchangeable into the foreign currency or, if applicable, concludes that the foreign currency is not exchangeable into its functional currency, the entity shall, at the date of initial application:
 - (i) translate affected foreign currency monetary items, and non-monetary items measured at fair value in a foreign currency, using the estimated spot exchange rate at that date; and
 - (ii) recognise any effect of initially applying the amendments as an adjustment to the opening balance of retained earnings.
- (b) when the entity uses a presentation currency other than its functional currency, or translates the results and financial position of a foreign operation, and, at the date of initial application, concludes that its functional currency (or the foreign operation's functional currency) is not exchangeable into its presentation currency or, if applicable, concludes that its presentation currency is not exchangeable into its functional currency (or the foreign operation's functional currency), the entity shall, at the date of initial application:

- (i) translate affected assets and liabilities using the estimated spot exchange rate at that date;
- (ii) translate affected equity items using the estimated spot exchange rate at that date if the entity's functional currency is hyperinflationary; and
- (iii) recognise any effect of initially applying the amendments as an adjustment to the cumulative amount of translation differences—accumulated in a separate component of equity.


...

Appendix A Application guidance

This appendix is an integral part of the Standard.

Exchangeability

- A1 The purpose of the following diagram is to help entities assess whether a currency is exchangeable and estimate the spot exchange rate when a currency is not exchangeable.



Step I: Assessing whether a currency is exchangeable (paragraphs 8 and 8A–8B)

- A2 Paragraphs A3–A10 set out application guidance to help an entity assess whether a currency is exchangeable into another currency. An entity might determine that a currency is not exchangeable into another currency, even though that other currency might be exchangeable in the other direction. For example, an entity might determine that currency PC is not exchangeable into currency LC, even though currency LC is exchangeable into currency PC.

Time frame

- A3 Paragraph 8 defines a spot exchange rate as the exchange rate for immediate delivery. However, an exchange transaction might not always complete instantaneously because of legal or regulatory requirements, or for practical reasons such as public holidays. A normal administrative delay in obtaining the other currency does not preclude a currency from being exchangeable into that other currency. What constitutes a normal administrative delay depends on facts and circumstances.

Ability to obtain the other currency

- A4 In assessing whether a currency is exchangeable into another currency, an entity shall consider its ability to obtain the other currency, rather than its intention or decision to do so. Subject to the other requirements in paragraphs A2–A10, a currency is exchangeable into another currency if an entity is able to obtain the other currency—either directly or indirectly—even if it intends or decides not to do so. For example, subject to the other requirements in paragraphs A2–A10, regardless of whether the entity intends or decides to obtain PC, currency LC is exchangeable into currency PC if an entity is able to either exchange LC for PC, or exchange LC for another currency (FC) and then exchange FC for PC.

Markets or exchange mechanisms

- A5 In assessing whether a currency is exchangeable into another currency, an entity shall consider only markets or exchange mechanisms in which a transaction to exchange the currency for the other currency would create enforceable rights and obligations. Enforceability is a matter of law. Whether an exchange transaction in a market or exchange mechanism would create enforceable rights and obligations depends on facts and circumstances.

Purpose of obtaining the other currency

- A6 Different exchange rates might be available for different uses of a currency. For example, a jurisdiction facing pressure on its balance of payments might wish to deter capital remittances (such as dividend payments) to other jurisdictions but encourage imports of specific goods from those jurisdictions. In such circumstances, the relevant authorities might:
- (a) set a preferential exchange rate for imports of those goods and a ‘penalty’ exchange rate for capital remittances to other jurisdictions, thus resulting in different exchange rates applying to different exchange transactions; or
 - (b) make the other currency available only to pay for imports of those goods and not for capital remittances to other jurisdictions.
- A7 Accordingly, whether a currency is exchangeable into another currency could depend on the purpose for which the entity obtains (or hypothetically might need to obtain) the other currency. In assessing exchangeability:
- (a) when an entity reports foreign currency transactions in its functional currency (see paragraphs 20–37), the entity shall assume its purpose in obtaining the other currency is to realise or settle individual foreign currency transactions, assets or liabilities.
 - (b) when an entity uses a presentation currency other than its functional currency (see paragraphs 38–43), the entity shall assume its purpose in obtaining the other currency is to realise or settle its net assets or net liabilities.
 - (c) when an entity translates the results and financial position of a foreign operation into the presentation currency (see paragraphs 44–47), the entity shall assume its purpose in obtaining the other currency is to realise or settle its net investment in the foreign operation.
- A8 An entity’s net assets or net investment in a foreign operation might be realised by, for example:
- (a) the distribution of a financial return to the entity’s owners;
 - (b) the receipt of a financial return from the entity’s foreign operation; or
 - (c) the recovery of the investment by the entity or the entity’s owners, such as through disposal of the investment.
- A9 An entity shall assess whether a currency is exchangeable into another currency separately for each purpose specified in paragraph A7. For example, an entity shall assess exchangeability for the purpose of reporting foreign currency transactions in its functional currency (see paragraph A7(a)) separately from exchangeability for the purpose of translating the results and financial position of a foreign operation (see paragraph A7(c)).

Ability to obtain only limited amounts of the other currency

- A10 A currency is not exchangeable into another currency if, for a purpose specified in paragraph A7, an entity is able to obtain no more than an insignificant amount of the other currency. An entity shall assess the significance of the amount of the other currency it is able to obtain for a specified purpose by comparing

that amount with the total amount of the other currency required for that purpose. For example, an entity with a functional currency of LC has liabilities denominated in currency FC. The entity assesses whether the total amount of FC it can obtain for the purpose of settling those liabilities is no more than an insignificant amount compared with the aggregated amount (the sum) of its liability balances denominated in FC.

Step II: Estimating the spot exchange rate when a currency is not exchangeable (paragraph 19A)

- A11 This Standard does not specify how an entity estimates the spot exchange rate to meet the objective in paragraph 19A. An entity can use an observable exchange rate without adjustment (see paragraphs A12–A16) or another estimation technique (see paragraph A17).

Using an observable exchange rate without adjustment

- A12 In estimating the spot exchange rate as required by paragraph 19A, an entity may use an observable exchange rate without adjustment if that observable exchange rate meets the objective in paragraph 19A. Examples of an observable exchange rate include:
- (a) a spot exchange rate for a purpose other than that for which an entity assesses exchangeability (see paragraphs A13–A14); and
 - (b) the first exchange rate at which an entity is able to obtain the other currency for the specified purpose after exchangeability of the currency is restored (first subsequent exchange rate) (see paragraphs A15–A16).

Using an observable exchange rate for another purpose

- A13 A currency that is not exchangeable into another currency for one purpose might be exchangeable into that currency for another purpose. For example, an entity might be able to obtain a currency to import specific goods but not to pay dividends. In such situations, the entity might conclude that an observable exchange rate for another purpose meets the objective in paragraph 19A. If the rate meets the objective in paragraph 19A, an entity may use that rate as the estimated spot exchange rate.
- A14 In assessing whether such an observable exchange rate meets the objective in paragraph 19A, an entity shall consider, among other factors:
- (a) *whether several observable exchange rates exist*—the existence of more than one observable exchange rate might indicate that exchange rates are set to encourage, or deter, entities from obtaining the other currency for particular purposes. These observable exchange rates might include an ‘incentive’ or ‘penalty’ and therefore might not reflect the prevailing economic conditions.
 - (b) *the purpose for which the currency is exchangeable*—if an entity is able to obtain the other currency only for limited purposes (such as to import emergency supplies), the observable exchange rate might not reflect the prevailing economic conditions.
 - (c) *the nature of the exchange rate*—a free-floating observable exchange rate is more likely to reflect the prevailing economic conditions than an exchange rate set through regular interventions by the relevant authorities.
 - (d) *the frequency with which exchange rates are updated*—an observable exchange rate unchanged over time is less likely to reflect the prevailing economic conditions than an observable exchange rate that is updated on a daily basis (or even more frequently).

Using the first subsequent exchange rate

- A15 A currency that is not exchangeable into another currency at the measurement date for a specified purpose might subsequently become exchangeable into that currency for that purpose. In such situations, an entity might conclude that the first subsequent exchange rate meets the objective in paragraph 19A. If the rate meets the objective in paragraph 19A, an entity may use that rate as the estimated spot exchange rate.
- A16 In assessing whether the first subsequent exchange rate meets the objective in paragraph 19A, an entity shall consider, among other factors:
- (a) *the time between the measurement date and the date at which exchangeability is restored*—the shorter this period, the more likely the first subsequent exchange rate will reflect the prevailing economic conditions.
 - (b) *inflation rates*—when an economy is subject to high inflation, including when an economy is hyperinflationary (as specified in IAS 29 *Financial Reporting in Hyperinflationary Economies*), prices often change quickly, perhaps several times a day. Accordingly, the first subsequent

exchange rate for a currency of such an economy might not reflect the prevailing economic conditions.

Using another estimation technique

- A17 An entity using another estimation technique may use any observable exchange rate—including rates from exchange transactions in markets or exchange mechanisms that do not create enforceable rights and obligations—and adjust that rate, as necessary, to meet the objective in paragraph 19A.

Disclosure when a currency is not exchangeable

- A18 An entity shall consider how much detail is necessary to satisfy the disclosure objective in paragraph 57A. An entity shall disclose the information specified in paragraphs A19–A20 and any additional information necessary to meet the disclosure objective in paragraph 57A.
- A19 In applying paragraph 57A, an entity shall disclose:
- (a) the currency and a description of the restrictions that result in that currency not being exchangeable into the other currency;
 - (b) a description of affected transactions;
 - (c) the carrying amount of affected assets and liabilities;
 - (d) the spot exchange rates used and whether those rates are:
 - (i) observable exchange rates without adjustment (see paragraphs A12–A16); or
 - (ii) spot exchange rates estimated using another estimation technique (see paragraph A17);
 - (e) a description of any estimation technique the entity has used, and qualitative and quantitative information about the inputs and assumptions used in that estimation technique; and
 - (f) qualitative information about each type of risk to which the entity is exposed because the currency is not exchangeable into the other currency, and the nature and carrying amount of assets and liabilities exposed to each type of risk.
- A20 When a foreign operation's functional currency is not exchangeable into the presentation currency or, if applicable, the presentation currency is not exchangeable into a foreign operation's functional currency, an entity shall also disclose:
- (a) the name of the foreign operation; whether the foreign operation is a subsidiary, joint operation, joint venture, associate or branch; and its principal place of business;
 - (b) summarised financial information about the foreign operation; and
 - (c) the nature and terms of any contractual arrangements that could require the entity to provide financial support to the foreign operation, including events or circumstances that could expose the entity to a loss.

Amendments to IFRS 1 *First-time Adoption of International Financial Reporting Standards*

Paragraphs 31C and D27 are amended and paragraph 39AI is added. New text is underlined and deleted text is struck through.

Presentation and disclosure

...

Explanation of transition to IFRSs

...

Use of deemed cost after severe hyperinflation

31C If an entity elects to measure assets and liabilities at fair value and to use that fair value as the deemed cost in its opening IFRS statement of financial position because of severe hyperinflation (see paragraphs D26–D30), the entity's first IFRS financial statements shall disclose an explanation of how, and why, the entity had, and then ceased to have, a functional currency that is subject to severe hyperinflation. ~~has both of the following characteristics:~~

- (a) ~~a reliable general price index is not available to all entities with transactions and balances in the currency.~~
- (b) ~~exchangeability between the currency and a relatively stable foreign currency does not exist.~~

...

Effective date

...

39AI *Lack of Exchangeability* (Amendments to IAS 21), issued in August 2023, amended paragraphs 31C and D27. An entity shall apply those amendments when it applies IAS 21 (as amended in August 2023).

...

Appendix D

Exemptions from other IFRSs

...

Severe hyperinflation

...

D27 The currency of a hyperinflationary economy is subject to severe hyperinflation if it has both of the following characteristics:

- (a) a reliable general price index is not available to all entities with transactions and balances in the currency.
- (b) ~~exchangeability between the currency is not exchangeable into and~~ a relatively stable foreign currency ~~does not exist~~. Exchangeability is assessed in accordance with IAS 21.

Mungesa e Këmbyeshmërisë (Mundësisë për Këmbim)

Ndryshime në SNK 21

Ndryshime në SNK 21 *Efektet e Ndryshimeve në Kurset e Këmbimit në Monedhat e Huaja*

Janë ndryshuar paragrafët 8 dhe 26. Janë shtuar paragrafët 8A–8B, 19A dhe titujt përkatës të tyre, paragrafët 57A–57B, 60L–60M dhe Shtojca A. Teksti i ri është i nënvizuar dhe teksti i fshirë është bërë me vijë në mes. Për lehtësi në lexim, teksti në Shtojcën A nuk është nënvizuar.

Përkufizimet

8 Termat e mëposhtëm janë përdorur në këtë Standard sipas këtyre kuptimeve specifike:

...

Një monedhë është e këmbyeshme në një monedhë tjetër nëse njësia ekonomike është në gjendje të marrë monedhën tjetër brenda një hapësire kohore që i lejon një vonesë administrative normale dhe përmes një mekanizimi (regjimi) tregu apo këmbimi në të cilin një transaksion këmbimi do të krijonte të drejta dhe detyrime të ekzekutueshme me forcë.

...

Shtjellim i hollësishëm i përkufizimeve

Të qenit e këmbyeshme (këmbyeshmëria) (paragrafët A2–A10)

8A Njësia ekonomike vlerëson nëse një monedhë është e këmbyeshme në një monedhë tjetër:

(a) në datën e matjes; dhe

(b) për qëllime specifike.

8B Nëse në datën e matjes për qëllimin specifik, njësia ekonomike nuk është në gjendje të marrë në këmbim përveçse një shumë të parëndësishme nga monedha tjetër, monedha nuk është e këmbyeshme në monedhën tjetër.

...

Vlerësimi i kursit të këmbimit të çastit (spot) kur një monedhë nuk është e këmbyeshme (paragrafët A11–A17)

19A Njësia ekonomike do të vlerësojë kursin e këmbimit të çastit (spot) në datën e matjes kur një monedhë nuk është e këmbyeshme në një monedhë tjetër (siç përshkruhet në paragrafët 8, 8A–8B dhe A2–A10) në atë datë. Objektivi i njësies ekonomike në vlerësimin e kursit të këmbimit të çastit (spot) është të vlerësojë kursin me të cilin do të ndodhte një transaksion këmbimi i zakonshëm në datën e matjes mes pjesëmarrësve në treg sipas kushteve ekonomike mbizotëruese.

Raportimi i transaksioneve në monedhë të huaj në monedhën funksionale

...

Raportimi në fund të periudhave të mëpasshme raportuese

...

- 26 Kur ka disa kurse këmbimi, kursi që përdoret është kursi me të cilin do të ishin kompensuar flukset monetare të ardhshme të përfaqësuara nga transaksioni ose teprica, sikur ky këmbim të kishte ndodhur në datën e matjes. Nëse këmbyeshmëria midis dy monedhave është përkohësisht e pamundur, atëherë do të përdoret kursi i parë pasardhës, me të cilin mund të kryhet këmbimi.

...

Dhënia e informacioneve shpjeguese

...

- 57A Kur njësia ekonomike vlerëson një kurs këmbimi të çastit (spot), sepse monedha nuk është e këmbyeshme në një monedhë tjetër (shiko paragrafin 19A), njësia ekonomike duhet të japë informacion shpjegues, që u mundëson përdoruesve të pasqyrave financiare të saj, të kuptojnë sesi monedha e pakëmbyeshme në një monedhë tjetër ndikon ose pritet që të ndikojë performancën financiare, pozicionin financiar dhe flukset monetare të njësisë ekonomike. Për të realizuar këtë objektiv, njësia ekonomike do të japë informacion shpjegues mbi:

- (a) natyrën dhe efektet financiare të monedhës jo të këmbyeshme në një monedhë tjetër;
- (b) kursin (kurset) e këmbit të çastit (spot) të përdorur;
- (c) procesin e vlerësimit; dhe
- (d) rreziqet ndaj të cilave është ekspozuar njësia ekonomike për shkak se monedha nuk është e këmbyeshme në një monedhë tjetër.

- 57B Në paragrafët A18–A20 specifikohet sesi njësia ekonomike zbaton paragrafin 57A.

Data e hyrjes në fuqi dhe periudha kalimtare

...

- 60L Mungesa e Këmbyeshmërisë, i publikuar në gusht 2023, ndryshoi paragrafët 8 dhe 26, si dhe shtoi paragrafët 8A–8B, 19A, 57A–57B dhe Shtojcën A. Njësia ekonomike duhet të zbatojë këto ndryshime për periudha raportuese vjetore që fillojnë me 1 janar 2025 e në vijim. Lejohet zbatimi përpara kësaj date. Nëse një njësi ekonomike zbaton ndryshimet për një periudhë më të hershme, ajo duhet të japë informacione shpjeguese për këtë fakt. Data e zbatimit fillestar është fillimi i periudhës vjetore të raportimit në të cilën njësia ekonomike zbaton për herë të parë këto ndryshime.

- 60M Kur zbaton Mungesën e Këmbyeshmërisë, njësia ekonomike nuk do të riparaqesë informacion krahasues. Por:

- (a) kur njësia ekonomike raporton transaksione në monedhë të huaj në monedhën e saj funksionale dhe në datën e zbatimit për herë të parë del në përfundimin se monedha e saj funksionale nuk është e këmbyeshme në monedhën e huaj ose, nëse është e zbatueshme, del në përfundimin se monedha e huaj nuk është e këmbyeshme në monedhën e saj funksionale, njësia ekonomike në datën e zbatimit për herë të parë duhet:
 - (i) të përkthejë zërat monetarë në monedhë të huaj të ndikuar dhe zërat jo monetarë të matur me vlerën e drejtë në një monedhë të huaj duke përdorur kursin e këmbimit të çastit (spot) të vlerësuar në atë datë; dhe
 - (ii) të njohë efektet e zbatimit për herë të parë të ndryshimeve si një rregullim të tepricës së çeljes së fitimeve të pashpërndara.

- (b) kur njësia përdor një monedhë paraqitjeje të ndryshme nga monedha e saj funksionale, ose përkthen rezultatet dhe pozicionin financiar të një operacioni të kryer jashtë vendit dhe në datën e zbatimit për herë të parë del në përfundimin se monedha funksionale e saj (ose monedha funksionale e operacionit të kryer jashtë vendit) nuk është e këmbyeshme në monedhën e saj të paraqitjes ose, nëse është e zbatueshme, del në përfundimin se monedha e saj e paraqitjes nuk është e këmbyeshme në monedhën funksionale të saj (ose në monedhën funksionale të operacionit të kryer jashtë vendit), në datën e zbatimit për herë të parë njësia ekonomike duhet:
- (i) të përkthejë aktivet dhe detyrimet e ndikuara duke përdorur kursin e këmbimit të çastit (spot) të vlerësuar në atë datë;
 - (ii) të përkthejë zërat e ndikuar të kapitalit neto duke përdorur kursin e këmbimit të çastit (spot) të vlerësuar në atë datë sikur monedha funksionale e njësisë ekonomike të ishte e një ekonomie hiperinflacioniste; dhe
 - (iii) të njohë efektet e zbatimit për herë të parë të ndryshimeve, si një rregullim të shumës së akumuluar të diferencave nga përkthimi—të grumbulluara në një përbërës të veçantë të kapitalit.


...

Shtojca A Udhëzime të zbatimit

Kjo shtojcë është pjesë integrale e Standardit.

Këmbyeshmëria

- A1 Qëllimi i diagramës në vijim është që të ndihmojë njësitë ekonomike të vlerësojnë nëse një monedhë është e këmbyeshme dhe të vlerësojnë kursin e këmbimit të çastit (spot) kur një monedhë nuk është e këmbyeshme.



Hapi I: Vlerësimi nëse një monedhë është e këmbyeshme (paragrafët 8 dhe 8A–8B)

- A2 Paragrafët A3–A10 paraqesin udhëzime të zbatimit për të ndihmuar njësinë ekonomike në vlerësimin nëse monedha është e këmbyeshme në një monedhë tjetër. Njësia ekonomike përcakton që monedha nuk është e këmbyeshme në një monedhë tjetër edhe pse monedha tjetër mund të jetë e këmbyeshme në monedhën e

njesisë ekonomike (drejtimi tjetër). Për shembull, njësia ekonomike mund të përcaktojë që monedha PC nuk është e këmbyeshme në monedhën LC edhe pse monedha LC është e këmbyeshme në monedhën PC.

Harku kohor

- A3 Paragrafi 8 e përkufizon kursin e këmbimi të çastit (spot) si kursi i këmbimit për livrimin e menjëhershëm. Megjithatë, një transaksion këmbimi jo gjithmonë mund të përfundojë menjëherë për shkak të kërkesave ligjore apo rregullatore, ose për arsye praktike, si ditët e festave zyrtare. Një vonesë administrative normale në marrjen e monedhës tjetër nuk e përjashton monedhën nga këmbyeshmëria me monedhën tjetër. Se çfarë përbën një vonesë normale administrative varet nga faktet dhe rrethanat.

Aftësia (kapaciteti) për të marrë monedhën tjetër

- A4 Kur vlerëson nëse një monedhë është e këmbyeshme në një monedhë tjetër, njësia ekonomike do të marrë në konsideratë më tepër aftësinë (kapacitetin) për të marrë monedhën tjetër sesa synimin apo vendimin e saj për ta bërë këtë. Në varësi të kërkesave të tjera të paragrafëve A2–A10, një monedhë është e këmbyeshme në një monedhë tjetër nëse njësia ekonomike është në gjendje të marrë (përfitojë) monedhën tjetër—drejtpërdrejt ose jo—edhe nëse synon ose vendos të mos e bëjë këtë. Për shembull, në varësi të kërkesave të tjera të paragrafëve A2–A10, pavarësisht nëse njësia ekonomike synon ose vendos të marrë PC, monedha LC është e këmbyeshme në monedhën PC nëse njësia ekonomike është në gjendje ose të këmbejë LC për PC, ose të këmbejë LC në një monedhë tjetër (FC) dhe më pas të këmbejë FC në PC.

Mekanizmat (Regjimet) e tregjeve ose të këmbimit

- A5 Kur vlerësohet nëse një monedhë është e këmbyeshme me një monedhë tjetër, njësia ekonomike do të marrë në konsideratë vetëm mekanizmat (regjimet) e tregjeve ose të këmbimit në të cilat një transaksion këmbimi të monedhës në një monedhë tjetër do të krijojë të drejta dhe detyrime të ekzekutueshme me forcë. Ekzekutimi me forcë (i pashmangshëm) është çështje ligjore. Nëse një transaksion këmbimi, në një mekanizëm (regjim) tregu ose këmbimi, do të krijojë të drejta dhe detyrime të ekzekutueshme me forcë varet nga faktet dhe rrethanat.

Qëllimi për të marrë monedhën tjetër

- A6 Kurse këmbimi të ndryshme mund të jenë të mundshme për përdorues të ndryshëm të një monedhe. Për shembull, një juridiksion, që ndeshet me presionin e bilancit të tij të pagesave, mund të dëshirojë të kufizojë pagesat e kapitalit (të tilla si pagesat e dividendëve) në juridiksione të tjera, por të nxisë importin e të mirave specifike nga këto juridiksione. Në rrethana të tilla, autoritetet përkatëse mund:
- (a) të vendosin një kurs këmbimi të preferuar për importin e këtyre të mirave dhe një kurs këmbimi ‘penalizues’ për pagesat e kapitalit në juridiksione të tjera, duke sjellë zbatimin e kurseve të ndryshme të këmbimit për transaksione të ndryshme këmbimi; ose
 - (b) të bëjnë monedhën tjetër të disponueshme vetëm për pagesën e importeve të këtyre të mirave dhe jo për pagesat e kapitalit në juridiksione të tjera.
- A7 Për pasojë, nëse një monedhë është e këmbyeshme në një monedhë tjetër mund të varet nga qëllimi për të cilin njësia ekonomike merr (apo hipotetakisht mund të ketë nevojë të marrë) monedhën tjetër. Për vlerësimin e këmbyeshmërisë:
- (a) kur njësia ekonomike raporton transaksionet në monedhë të huaj në monedhën e saj funksionale (shiko paragrafët 20–37), njësia ekonomike do të supozojë se qëllimi në marrjen e monedhës tjetër është realizimi ose shlyerja individuale e transaksioneve në monedhë të huaj, aktiveve ose detyrimeve.
 - (b) kur njësia ekonomike përdor një monedhë paraqitjeje të ndryshme nga monedha e saj funksionale (shiko paragrafët 38–43), njësia ekonomike do të supozojë se qëllimi në marrjen e monedhës tjetër është realizimi ose shlyerja e aktiveve neto ose detyrimeve neto të saj.
 - (c) kur njësia ekonomike përkthen rezultatet dhe pozicionin financiar të një operacioni të kryer jashtë vendit në monedhën e paraqitjes (shiko paragrafët 44–47), njësia ekonomike do të supozojë se qëllimi në marrjen e monedhës tjetër është realizimi ose shlyerja e investimit neto të saj në operacionin e kryer jashtë vendit.
- A8 Realizimi i aktiveve neto ose investimit neto në një operacion të kryer jashtë vendit të njësisë ekonomike mund të arrihet për shembull:
- (a) me shpërndarjen e një kthimi financiar tek pronarët e njësisë ekonomike;

- (b) me marrjen e një kthimi financiar nga operacioni i kryer jashtë vendit i njësisë ekonomike; ose
- (c) me rikuperimin e investimit nga njësia ekonomike ose pronarët e saj, si p.sh. përmes nxjerrjes jashtë përdorimit të investimit.

A9 Njësia ekonomike do të vlerësojë nëse monedha është e këmbyeshme në një monedhë tjetër veçmas për secilin qëllim të specifikuar në paragrafin A7. Për shembull, njësia ekonomike do të vlerësojë këmbyeshmërinë për qëllimin e raportimit të transaksionit në monedhë të huaj në monedhën e saj funksionale (shiko paragrafin A7(a)) veçmas nga këmbyeshmëria për qëllimin e përkthimit të rezultateve dhe pozicionit financiar në një operacion të kryer jashtë vendit (shiko paragrafin A7(c)).

Aftësia (kapaciteti) për të marrë vetëm shuma të kufizuara të monedhës tjetër

A10 Një monedhë nuk është e këmbyeshme në një monedhë tjetër nëse, për një qëllim të specifikuar në paragrafin A7, njësia ekonomike nuk është në gjendje të marrë më tepër se një shumë të parëndësishme nga monedha tjetër. Njësia ekonomike do të vlerësojë rëndësinë e shumës në monedhën tjetër, që është në gjendje të marrë për qëllimin specifik, duke krahasuar atë shumë me shumën gjithsej të monedhës tjetër të kërkuar për atë qëllim. Për shembull, njësia ekonomike me monedhën funksionale LC ka detyrime të përcaktuara në monedhën FC. Njësia ekonomike vlerëson nëse shuma gjithsej e FC, që mund të marrë me qëllim shlyerjen e atyre detyrimeve, nuk është veçse një shumë e parëndësishme krahasuar me shumën totale (gjithsej) të tepricave të detyrimeve të saj të përcaktuara në monedhën FC.

Hapi II: Vlerësimi i kursit të këmbimit të çastit (spot) kur një monedhë nuk është e këmbyeshme (paragrafi 19A)

- A11 Ky Standard nuk specifikon sesi një njësi ekonomike vlerëson kursin e këmbimit të çastit (spot) për të plotësuar objektivin në paragrafin 19A. Një njësi ekonomike mund të përdorë një kurs këmbimi të vrojtueshëm pa rregullime (shiko paragrafët A12–A16) ose një teknikë tjetër vlerësimi (shiko paragrafin A17).

Përdorimi i një kursi këmbimi të vrojtueshëm pa rregullim

- A12 Kur vlerëson kursin e këmbimit të çastit (spot) siç kërkohet nga paragrafi 19A, njësi ekonomike mund të përdorë një kurs këmbimi të vrojtueshëm pa rregullim nëse ai kurs plotëson objektivin në paragrafin 19A. Shembuj të një kursi këmbimi të vrojtueshëm përfshijnë:
- (a) një kurs këmbimi i çastit (spot) për një qëllim të ndryshëm nga ai për të cilin njësi ekonomike vlerëson këmbyeshmërinë (shiko paragrafët A13–A14); dhe
 - (b) kursin e parë të këmbimit me të cilin njësi ekonomike është në gjendje të marrë monedhën tjetër për qëllimin e specifikuar pasi është përcaktuar këmbyeshmëria e monedhës (kursi i parë pasardhës i këmbimit) (shiko paragrafët A15–A16).

Përdorimi i një kursi këmbimi të vrojtueshëm për një qëllim tjetër

- A13 Një monedhë që nuk është e këmbyeshme në një monedhë tjetër për një qëllim mund të jetë e këmbyeshme në atë monedhë për një qëllim tjetër. Për shembull, njësi ekonomike mund të jetë në gjendje të marrë një monedhë për importin e të mirave specifike (të caktuara), por jo për të paguar dividendët. Në situata të tilla, njësi ekonomike mund të dalë në përfundimin se një kurs këmbimi i vrojtueshëm për një qëllim tjetër plotëson objektivin në paragrafin 19A. Nëse kursi plotëson objektivin në paragrafin 19A, njësi ekonomike mund të përdorë atë kurs si kursin e vlerësuar të këmbimit të çastit (spot).
- A14 Në vlerësimin nëse një kurs i tillë i vrojtueshëm i këmbimit plotëson objektivin në paragrafin 19A, njësi ekonomike do të marrë në konsideratë mes faktorëve të tjerë:
- (a) *nëse ekzistojnë disa kurse këmbimi të vrojtueshme*—ekzistenca e më shumë se një kursi këmbimi të vrojtueshëm mund të tregojë që kurset e këmbimit janë vendosur për të nxitur ose penguar njësitë ekonomike në marrjen e shumës në monedhën tjetër për qëllime të caktuara. Këto kurse këmbimi të vrojtueshme mund të përfshijnë një ‘stimul’ ose ‘penalitet’ dhe prandaj mund të mos reflektojnë kushtet ekonomike mbizotëruese.
 - (b) *qëllimin për të cilin monedha është e këmbyeshme*—nëse njësi ekonomike është në gjendje të marrë monedhën tjetër vetëm për qëllime të caktuara (si p.sh. për të importuar furnizime urgjente), kursi i këmbimit të vrojtueshëm mund të mos reflektojë kushtet ekonomike mbizotëruese.
 - (c) *natyrën e kursit të këmbimit*—ka më shumë mundësi që një kurs këmbimi i vrojtueshëm në tregun e lirë (i ndryshueshëm) të pasqyrojë kushtet ekonomike mbizotëruese sesa një kurs këmbimi të përcaktuar përmes ndërhyrjeve të rregullta nga autoritetet përkatëse.
 - (d) *frequencën me të cilën përditësohen kurset e këmbimit*—ka më pak mundësi që një kurs këmbimi i vrojtueshëm, i pandryshuar në kohë, të pasqyrojë kushtet ekonomike mbizotëruese krahasuar me një kurs këmbimi të vrojtueshëm që përditësohet ditë pas dite (ose edhe më shpesh).

Përdorimi i kursit të parë pasardhës të këmbimit

- A15 Një monedhë që nuk është e këmbyeshme në një monedhë tjetër në datën e matjes për një qëllim specifik mund të bëhet më pas e këmbyeshme në atë monedhë për atë qëllim. Në situata të tilla, njësi ekonomike mund të dalë në përfundimin se kursi i parë pasardhës i këmbimit plotëson objektivin në paragrafin 19A. Nëse kursi plotëson objektivin në paragrafin 19A, njësi ekonomike mund të përdorë atë kurs si një kurs të vlerësuar të këmbimit të çastit (spot).
- A16 Kur vlerëson nëse kursi i parë pasardhës i këmbimit plotëson objektivin në paragrafin 19A, njësi ekonomike do të marrë në konsideratë mes faktorëve të tjerë:

- (a) *kohën mes datës së matjes dhe datës në të cilën përcaktohet këmbyeshmëria*—sa më e shkurtër të jetë kjo periudhë, aq më shumë ka mundësi që kursi i parë pasardhës i këmbimit të pasqyrojë kushtet ekonomike mbizotëruese.
- (b) *normat e inflacionit*—kur një ekonomi është objekt i inflacionit të lartë, përfshirë rastin kur një ekonomi është hiperinflacioniste (siç specifikohet në SNK 29 *Raportimi Financiar në Ekonomitë Hiperinflacioniste*), çmimet ndryshojnë shpesh papritur, ndoshta disa herë gjatë një dite. Për pasojë, kursi i parë pasardhës i këmbimit për një monedhë të një ekonomie të tillë mund të mos pasqyrojë kushtet ekonomike mbizotëruese.

Përdorimi i një teknike tjetër vlerësimi

- A17 Njësia ekonomike, që përdor një tjetër teknikë vlerësimi, mund të përdorë çdo kurs këmbimi të vrojtueshëm—përfshirë kurset nga transaksionet e këmbimit në mekanizmat (regjimet) e tregjeve ose të këmbimit që nuk krijojnë të drejta dhe detyrime të ekzekutueshme me forcë—dhe ta rregullojë atë kurs, sipas nevojës, për të plotësuar objektivin në paragrafin 19A.

Dhënia e informacioneve shpjeguese kur një monedhë nuk është e këmbyeshme

- A18 Njësia ekonomike do të marrë në konsideratë sesa informacion është i nevojshëm për të plotësuar objektivin e dhënies së informacioneve shpjeguese në paragrafin 57A. Njësia ekonomike do të japë informacionin e specifikuar në paragrafët A19–A20 dhe çdo informacion shtesë të nevojshëm për të plotësuar objektivin e dhënies së informacioneve shpjeguese në paragrafin 57A.
- A19 Kur zbaton paragrafin 57A, njësia ekonomike jep informacione shpjeguese për:
- (a) monedhën dhe një përshkrim të kufizimeve që sjell pakëmbyeshmëria e kësaj monedhe në monedhën tjetër;
 - (b) një përshkrim të transaksioneve që ndikohen;
 - (c) vlerën kontabël (neto) të aktiveve dhe detyrimeve që ndikohen;
 - (d) kursin e këmbimit të çastit (spot) të përdorur dhe nëse këto kurse janë:
 - (i) kurse këmbimi të vrojtueshme pa rregullime (shiko paragrafët A12–A16); ose
 - (ii) kurse këmbimi të çastit (spot) të vlerësuara duke përdorur një teknikë tjetër vlerësimi (shiko paragrafin A17);
 - (e) një përshkrim të çdo teknike vlerësimi që njësia ekonomike ka përdorur, si dhe informacion cilësor dhe sasior mbi inputet dhe supozimet e përdorura në atë teknikë vlerësimi; dhe
 - (f) informacion cilësor mbi çdo tip rreziku ndaj të cilit është ekspozuar njësia ekonomike, sepse monedha nuk është e këmbyeshme në një monedhë tjetër, si dhe natyrën dhe vlerën kontabël (neto) të aktiveve dhe detyrimeve të ekspozuara për secilin tip rreziku.
- A20 Kur monedha funksionale e një operacioni të kryer jashtë vendit nuk është e këmbyeshme në monedhën e paraqitjes ose, nëse është e zbatueshme, monedha e paraqitjes nuk është e këmbyeshme në monedhën funksionale të një operacioni të kryer jashtë vendit, njësia ekonomike do të japë informacion shpjegues:
- (a) për emrin e operacionit të kryer jashtë vendit; nëse operacioni i kryer jashtë vendit është filial, operacion i përbashkët, sipërmarrje e përbashkët ose degë; dhe vendin kryesor të biznesit;
 - (b) informacion financiar të përmbledhur për operacionin e kryer jashtë vendit; dhe
 - (c) për natyrën dhe kushtet e çdo marrëveshjeje kontraktuale që mund të kërkojë që njësia të japë mbështetje financiare ndaj operacionit të kryer jashtë vendit, përfshirë ngjarjet ose rrethanat që mund të ekspozojë njësinë ekonomike ndaj një humbjeje.

Ndryshimet në SNRF1 *Adoptimi për Herë të Parë i Standardeve Ndërkombëtare të Raportimit Financiar*

Paragrafët 31C dhe D27 janë ndryshuar dhe është shtuar paragrafi 39AI. Teksti i ri është i nënvizuar dhe teksti i fshirë është bërë me vijë në mes.

Paraqitja dhe dhënia e informacioneve shpjeguese

...

Shpjegimi i kalimit në SNRF-të

...

Përdorimi i kostos së supozuar pas hiperinflacionit të ashpër

31C Nëse një njësi ekonomike zgjedh që të masë aktivet dhe detyrimet me vlerë të drejtë dhe të përdorë këtë vlerë të drejtë si kosto e supozuar në çeljen e pasqyrës së pozicionit të saj financiar sipas SNRF-ve për shkak të hiperinflacionit të ashpër (shiko paragrafët D26–D30), pasqyrat e para financiare të njësisë ekonomike sipas SNRF-ve do të japin shpjegim mbi mënyrën dhe arsyen përse njësi ekonomike kishte dhe më pas ndaloi së pasuri një monedhë funksionale që është subjekt i hiperinflacionit të ashpër ~~me dy karakteristikat e mëposhtme:~~

- (a) ~~një indeks çmimi i përgjithshëm i besueshëm nuk është i disponueshëm për të gjitha njësitë ekonomike me transaksione dhe teprica në monedhë të huaj.~~
- (b) ~~këmbyeshmëria midis monedhës dhe një monedhe të huaj të qëndrueshme nuk ekziston.~~

...

Data e hyrjes në fuqi

...

39AI Mungesa e Këmbyeshmërisë (Ndryshime në SNK 21), i publikuar në gusht 2023, ndryshoi paragrafët 31C dhe D27. Njësi ekonomike do të zbatojë këto ndryshime kur ajo zbaton SNK 21 (të ndryshuar në gusht 2023).

...

Shtojca D

Përfshirje nga SNRF-të e tjera

...

Hiperinflacion i ashpër

...

D27 Monedha e një ekonomie me hiperinflacion i nënshtrohet hiperinflacionit të ashpër nëse ajo ka dy karakteristikat e mëposhtme:

- (a) një indeks çmimi i përgjithshëm i besueshëm nuk është i disponueshëm për të gjitha njësitë ekonomike me transaksione dhe tepër në atë monedhë.
- (b) ~~këmbyeshmëria midis monedha nuk është e këmbyeshme në dhe një monedhë të huaj relativisht të qëndrueshme nuk ekziston.~~ Këmbyeshmëria vlerësohet në përputhje me SNK 21.